



mu Luvra

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 103, datë 16.7.2015

PËR

**MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS
SË QENDRËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE
TË INTEGRUARA**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Struktura e Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara të jetë, gjithsej, 73 veta.
4. Urdhri nr.266, datë 16.12.2014, i Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

STRUKTURA E QENDRËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA



